Shënime sqaruese paraqesin një përshkrim të shkurtër mbi përmbajtjen, periodicitetin dhe burimin e grafikëve dhe tabelave të paraqitura në këtë publikim.

PJESA I: GRAFIKËT

Grafiku 1. Asetet e korporatave financiare

Përshkrimi: Korporatat financiare përbëjnë korporatat rezidente që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar. Të dhënat e paraqitura përfshijnë BQK-në, korporatat tjera depozituese (bankat komerciale), korporatat tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, dhe ndihmësit financiar). Të dhënat e paraqitura janë të dhëna të agreguara.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafiku 2. Asetet e jashtme neto të korporatave financiare

Përshkrimi: Asetet e jashtme neto përbëhen nga kërkesat ndaj jo rezidentëve minus obligimet ndaj jo rezidentëve. Ky zë llogaritet kur kërkesave ndaj jo rezidentëve i zbriten obligimet ndaj jo rezidentëve. Në këtë kontekst përfshihen asetet e jashtme neto të BQK-së, korporatave tjera depozituese (bankave komerciale), korporatave tjera financiare (institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, dhe ndihmësit financiar).

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafiku 3. Ecuria e asetëve të jashtme neto të korporatave financiare

Përshkrimi: Ecuria e asetëve të jashtme neto të korporatave financiare llogaritet në bazë vjetore në nivel të BQK-së, korporatave tjera depozituese (bankave komerciale), korporatave tjera financiare (institucioneve mikrofinanciare, kompanive të sigurimeve, fondeve pensionale, dhe ndihmësve financiar). Ecuria e asetëve të jashtme të korporatave tjera financiare është përlogaritur duke i agreguar vlerën e asetëve të këtyre korporatave dhe më pastaj duke e llogaritur normën vjetore të rritjes.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 4.1, dhe 5.1

Grafiku 4. Depozitat në BQK sipas sektorëve

Përshkrimi: Në Kosovë, funksionin e bankës qendrore e kryen Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Ndarja sektoriale e depozitave është bazuar në standardet ndërkombëtare statistikore. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale, ndërsa korporatat tjera financiare përbëhen nga kompanitë e sigurimeve dhe fondet pensionale. Depozitat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë paraqitur të ndara nga depozitat e qeverisë qendrore.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 6.2

Grafiku 5. Depozitat në korporatat tjera depozituese sipas sektorëve dhe valutave

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Depozitat e qeverisë përfshijnë depozitat e qeverisë qendrore (p.sh. ministritë, etj) dhe lokale (p.sh. komunat). Korporatat tjera financiare përfshijnë të gjitha institucionet financiare përveç bankës qendrore dhe korporatave tjera depozituese të cilat raportohen si të veçanta. Korporatat publike jofinanciare përfshijnë korporatat publike (p.sh. PTK-ja, KEK-u, etj), ndërsa korporatat tjera financiare përfshijnë kompanitë private jofinanciare. Kategoria e ekonomive familjare përfshin të gjitha ekonomitë familjare që kanë llogari bankare, ndërsa ajo e jo rezidentëve përfshin të gjithë jo rezidentët që kanë llogari bankare në Kosovë. Pjesëmarrja e depozitave në valutën euro në gjithsej depozitat është bërë duke pjesëtuar depozitat në valutën euro me gjithsej depozitat. Për më shumë rreth ndarjes sektoriale dhe kriterit të rezidencës, konsultoni Metodikën mbi Statistikat Monetare dhe Financiare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 8.1 dhe 8.5

Grafiku 6. Depozitat në korporatat tjera depozituese sipas maturiteteve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Klasifikimi i depozitave në maturitete është bërë bazuar në kriterin maturimit origjinal (p.sh. nëse në janar 2009 kemi depozitim për një afat maturimit një vjeçar, atëherë ky afatizim do të raportohet në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin kur të kryhet afatizimi).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 8.1 dhe 8.5

Grafiku 7. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas sektorëve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ndarja e sektoriale kredive është bazuar në sektorin që i është dhënë kredia. Nëse kredia i është dhënë kompanisë atëherë ajo kredi klasifikohet si kredi ndaj korporatave jofinanciare (publike ose private).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 9.1

Grafiku 8. Kreditë e reja të korporatave tjera depozituese sipas sektorëve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jo kumulative (p.sh. kreditë për muajin shkurt 2010 paraqesin vetëm kreditë e dhëna gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 9.2

Grafiku 9. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas sektorëve ekonomik

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera

depozituese janë bankat komerciale. Ndarja e kredive sipas sektorëve ekonomik është bazuar në klasifikimin NACE, që është ndarje e kredive sipas qëllimit.¹

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 9.3

Grafiku 10. Kreditë e korporatave tjera depozituese sipas maturiteteve

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ky klasifikim i kredive sipas maturiteteve është bazuar në kriterin origjinal (p.sh. nëse në janar 2009 janë dhënë kredi për një afat maturimit një vjeçar, atëherë këto kredi do të raportohet në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin sa të kryhet afatizimi).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 9.1

Grafiku 11. Ecuria e kredive dhe depozitave në korporatat tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Ecuria e kredive dhe depozitave është bërë në bazë vjetore përmes formulës së rritjes/zvoglimit vjetor. Raporti i kredive në depozita përfshinë të gjitha kreditë pjesëtuar me depozitat, duke përjashtuar depozitat ndërbankare.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 7.1 dhe 7.2

Grafiku 12. Normat e interesit në depozita dhe kredi të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Normat e interesit në depozita dhe kredi llogariten duke përdoruar formulën e normës efektive të interesit bazuar në mesataren e ponderuar aritmetike. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$AAR = \left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1$$

¹ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

ku AAR është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1).

Këto të dhëna janë jo kumulative që përfshijnë kontratat e reja gjatë muajit përkatës. Për më shumë rreth llogaritjes së normës së interesit konsultoni [Metodikën mbi Statistikat Monetare dhe Financiare](#).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 10.1 dhe 10.2

Grafiku 13. Të hyrat dhe shpenzimet e korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Në kuadër të të hyrave përfshihen të gjitha të hyrat nga aktiviteti bankar, si të hyrat nga interesi, të hyrat jo nga interesi, etj. ndërsa në kuadër të shpenzimeve përfshihen shpenzimet nga interesi, shpenzimet tjera jo nga interesi, shpenzimet administrative (përfshirë edhe shpenzimet e stafit të bankave). Të dhënat janë të agreguara në nivel të korporatave tjera depozituese. Të dhënat janë kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 11.1

Grafiku 14. Ecuria e të hyrave në korporatat tjera depozituese dhe kontribuuesit

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Rritja e të hyrave llogaritet duke përdorur të dhënat kumulative brenda vitit kalendarik, përmes formulës së rritjes. Në mënyrë që të identifikohet ndikimi i secilit komponent, është përdorur formula e kontributit (pikë përqindja):

$$\text{Pikë përqindja} = \frac{(g_0 - g_{-1})}{z_{-1}} * 100$$

ku variabla g është pjesë e variablës z .

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 11.1

Grafiku 15. Ecuria e shpenzimeve në korporatat tjera depozituese dhe kontribuuesit

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Rritja e shpenzimeve llogaritet duke përdorur të dhënat kumulative brenda vitit kalendarik, përmes formulës së rritjes. Në mënyrë që të identifikohet ndikimi i secilit komponent, është përdorur formula e kontributit (pikë përqindja):

$$\text{Pikë përqindja} = \frac{(g_0 - g_{-1})}{z_{-1}} * 100$$

ku variabla g është pjesë e variablës z .

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 11.1

Grafiku 16. Buxheti i Kosovës

Përshkrimi: Qeveria e përgjithshme paraqet institucionin me fuqi legjislative, juridike dhe ekzekutive në territorin e një shteti dhe përbëhet nga qeveria qendrore, qeveria federale, qeveria lokale dhe fondet e sigurimit social. Në rastin e Kosovës, ekzistojnë dy nivele, dhe atë qeveria e përgjithshme dhe qeveria lokale. Në kuadër të buxhetit të Kosovës prezantohen të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Të dhënat e prezantuara janë të dhëna kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009). Diferenca në mes të të hyrave dhe shpenzimeve paraqet bilancin qeveritar.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 17.1

Grafiku 17. Çmimet

Përshkrimi: Statistikat mbi çmimet janë paraqitur bazuar në ndryshimin vjetor të çmimeve dhe sipas sistemit të mesatares vjetore. Përderisa ndryshimi vjetor është bazuar në formulën e rritjes vjetore, mesatarja vjetore përdoret duke marrë për bazë mesataren e 12 muajve të fundit dhe pjesëtuar me mesataren e 12 muajve të parafundit (p.sh. çmimet për dhjetor 2009 janë llogaritur duke marrë për bazë mesataren e indekseve për periudhën janar 2009 - dhjetor 2009 dhe duke pjesëtuar me mesataren janar 2008 - dhjetor 2008).

Formula për llogaritjen e ndryshimit vjetor si dhe të mesatares vjetore të çmimeve është me sa vijon:

$$\text{Ndryshimi vjetor} = \left[\left(\frac{CPI^{Y,m}}{CPI^{Y-1,m}} \right) - 1 \right] * 100$$

ku $CPI^{Y,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit aktual, ndërsa $CPI^{Y-1,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit paraprak.

$$\text{Mesatarja vjetore} = \frac{\sum_{i=1}^m CPI^{Y,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-1,12}}{\sum_{i=1}^m CPI^{Y-1,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-2,12}}$$

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 19.1

Grafiku 18. Kategoritë kryesore të çmimeve

Përshkrimi: Kategoritë kryesore të çmimeve kanë të bëjnë me strukturën e indeksit të çmimeve. Përqindjet e llogaritura janë bërë bazuar në ndryshimin vjetor. Ndarja në kategoritë si ushqimi dhe pijet jo alkoolike, pijet alkoolike, etj bazohet në sistemin COICOP (Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit).²

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 19.1

Grafiku 19. Çmimet e importit dhe çmimet e prodhimit

Përshkrimi: Kuadër të çmimeve të importit përfshihen çmimet e artikujve konsumues të cilët importohen duke përdorur peshat specifike. Ndërsa tek çmimet prodhimit përfshihen çmimet e prodhimeve vendore po ashtu duke përdorur peshat specifike.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 19.2

Grafiku 20. Kursi devizor kundrejt valutës euro

Përshkrimi: Kursi devizor përpilohet bazuar në mesataren mujore të kursit të valutave si leku shqiptar, frangu zviceran, funta britanike, kuna kroate, denari maqedon, dinari serb, lira turke dhe dollari amerikan.

² Për më shumë rreth klasifikimit COICOP shih <http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/REGCST.asp?Cl=5>

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 24.1

Grafiku 21. Norma reale efektive e këmbimit

Përshkrimi: Norma Reale Efektive të Këmbimit (NREK) llogaritet duke përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Para se të llogaritet NREK, që më parë duhet të llogarisim Normën Nominale Efektive e Këmbimit (NNEK). Formula lidhur me llogaritjen e NNEK-ut është me sa vijon:

$$NNEK_t = 100 \sum_{i=1}^n \frac{E_{it}}{E_{i0}} w_i$$

ku i paraqet valutat individuale të vendeve, E_{it} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendeve në baza mujore (t) e definuar si numri i njësive të valutës së vendit (i) për një njësi të valutës vendore, E_{i0} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendit përkatës në periudhën bazë, dhe w_i është pesha për valutën e vendit (i).

NREK-u është llogaritur bazuar në formulën me sa vijon:

$$NREK_t = \sum_{i=1}^n \frac{w_i P_{dt}}{P_{ft}} NNEK_t$$

ku P_{ft} paraqet indeksin për çmimet e huaja në baza mujore (t) për secilin vend veç e veç duke krahasuar me periudhën bazë, përderisa P_{dt} paraqet IÇK-në e Kosovës në baza mujore (t) krahasuar me periudhën bazë.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: 24.2

Grafiku 22. Bilanci tregtar

Përshkrimi: Në kuadër të bilancit tregtar përfshihen importi dhe eksporti i rregullt me të gjitha shtetet, respektivisht kur importeve i zbriten eksportet. Të dhënat mbi importin dhe eksportin publikohen kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 22.1

Grafiku 23. Eksporti i mallrave

Përshkrimi: Në kuadër të eksporteve ndaj BE-së përfshihen të gjitha vendet e Bashkësisë Evropiane. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s përfshihen Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, dhe Shqipëria. Kategoria e vendeve tjera evropiane përfshihen shtetet si Zvicra, Rusia, Ukraina, Turqia, etj. Ndërsa në kategorinë e shteteve jo evropiane përfshihen të gjitha shtetet që nuk janë në kontinentin evropian si SHBA, Kina, Japoni, India, Egjipti, etj.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 23.1

Grafiku 24. Importi i mallrave

Përshkrimi: Në kuadër të importeve ndaj BE-së përfshihen të gjitha vendet e Bashkësisë Evropiane. Në kuadër të vendeve të CEFTA-s përfshihen Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, dhe Shqipëria. Kategoria e vendeve tjera evropiane përfshihen shtetet si Zvicra, Rusia, Ukraina, Turqia, etj. Ndërsa në kategorinë e shteteve jo evropiane përfshihen të gjitha shtetet që nuk janë në kontinentin evropian si SHBA, Kina, Japoni, India, Egjipti, etj.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 23.5

PJESA II: TABELAT ³

Tabela 1. Pasqyra e korporatave financiare

Përshkrimi: Korporatat financiare përbëjnë korporatat rezidente që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe mund të jenë korporata depozituese dhe korporata tjera financiare. Pasqyra e korporatave financiare paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave financiare në raport me sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real dhe llogaritet bazuar në pasqyrat e korporatave depozituese (BQK-së dhe bankave komerciale) dhe korporatave tjera financiare (kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare, dhe menaxherëve të aseteve). Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 3.2, 4.1, 4.2, 5.1 dhe 5.2

³ Shënimet sqaruese i referohen grup-tabelave që për arsye të prezantimit në Buletin Mujor Statistikor janë paraqitur të ndara (p.sh. Shënimet sqaruese do të paraqiten në nivel të Pasqyrës e korporatave financiare, që përfshinë tabelën 1.1. Asetet e jashtme neto dhe kërkesat e brendshme dhe tabelën 1.2. Obligimet).

Tabela 2. Pasqyra e korporatave depozituese

Përshkrimi: Korporatat depozituese përbëhen nga banka qendrore dhe korporatat tjera depozituese (bankat komerciale). Pasqyra e korporatave depozituese paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave depozituese në raport me korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real dhe llogaritet bazuar në pasqyrën e BQK-së dhe të korporatave tjera depozituese. Tek korporatat depozituese konsolidimi bëhet në nivel të BQK-së dhe korporatave tjera depozituese. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Koncepti mbi paranë e gjerë përfshin vetëm depozitat të cilët janë pjesë e parasë së gjerë dhe jo paranë e gatshme. Këtu hyjnë depozitat e korporatave tjera financiare (kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, etj), depozitat e korporatave jofinanciare, ekonomive familjare, dhe OJSHEF-ve. Ky definimin është konsistent me definimin e Bankës Qendrore Evropiane.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 3.1, 3.2, 4.1 dhe 4.2

Tabela 3. Pasqyra e BQK-së

Përshkrimi: Pasqyra e BQK-së llogaritet bazuar në bilancin e gjendjes së BQK-së dhe përfshin pozicionin financiar të BQK-së në raport me korporatat tjera depozituese, korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real dhe llogaritet bazuar në bilancin e gjendjes së BQK-së. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 6.1 dhe 6.2

Tabela 4. Pasqyra e korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Pasqyra e korporatave tjera depozituese paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave tjera depozituese në raport me BQK-në, korporatat tjera financiare, sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Pasqyra e korporatave tjera depozituese përpilohet bazuar në bilancin e gjendjes së korporatave tjera depozituese. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti. Ekzistojnë disa ndryshime metodike në kuadër të obligimeve të korporatave tjera depozituese të cilat janë paraqitur në kuadër të shënimeve sqaruese të Tabelës 8.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Tabela 7.1 dhe 7.2

Tabela 5. Pasqyra e korporatave tjera financiare

Përshkrimi: Pasqyra e korporatave financiare përpilohet bazuar në bilancet e gjendjes të kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare, dhe menaxherët e aseteve. Pasqyra e korporatave tjera financiare paraqet pozicionin financiar (gjendjen e konsoliduar) të korporatave tjera financiare në raport me korporatat depozituese (bankën qendrore dhe bankat komerciale), sektorin e jashtëm, sektorin fiskal dhe sektorin real. Pasqyra e korporatave tjera financiare llogaritet bazuar në pasqyrën e pasqyrën e kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, institucioneve mikrofinanciare dhe menaxherëve të aseteve. Në kontekst të prezantimit, pasqyra dallon nga bilanci i gjendjes në atë se në bilancin e gjendjes i jepet përparësi instrumentit e më pastaj sektorit, ndërsa në pasqyra aplikohet e kundërta, së pari paraqitet sektori e më pastaj instrumenti.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 6. Bilanci i gjendjes së BQK-së

Përshkrimi: Bilanci i gjendjes së BQK-së paraqet pozicionin financiar të BQK-së. Në kuadër të korporatave tjera financiare që janë paraqitur në anën e obligimeve të BQK-së përfshihen depozitat e kompanive të sigurimit dhe fondeve pensionale. Depozitat e qeverisë përfshijnë edhe depozitat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por që janë paraqitur si të ndara.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 7. Bilanci i gjendjes të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese paraqet gjendjen e agreguar të këtij nën sektori. Që nga qershori 2004 ekziston ndryshim metodik në bilancin e gjendjes së korporatave të tjera depozituese. Kjo konsiston me fillimin e zbatimit të projektit statistikor Raporti Statistikor Bankar dhe Raporti mbi Normat e Kamatës. Për më shumë rreth ndryshimeve metodike, shih sqarimin e dhënë në kuadër të Tabelës 8.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 8. Depozitat në korporatat tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Depozitat në korporatat tjera depozituese janë të ndara sipas sektorëve dhe nën sektorëve si dhe sipas valutave. Deri në maj 2004, struktura e depozitave ka qenë e ndarë në depozitat e personave fizik dhe personave juridik. Në kuadër të depozitave të personave juridik janë përfshirë depozita e të gjitha institucioneve përveç atyre bankare dhe të ekonomive familjare. Për më shumë, në kuadër të depozitave të ekonomive familjare, deri në maj 2004, janë përfshirë edhe depozitat e OJSHEF-ve. Që nga qershori 2004 e deri në dhjetor 2007, depozitat e kompanive të sigurimit përfshijnë edhe depozitat e fondeve pensionale. Klasifikimi i depozitave në maturitete është bërë bazuar në kriterin maturimit origjinal (p.sh. nëse në janar 2009 kemi depozitim për një afat maturimit një vjeçar, atëherë ky afatizim do të raportohet në kuadër të zërit “Deri në një vit” deri në momentin kur të kryhet afatizimi).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 9. Kreditë e korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Kreditë e korporatave tjera depozituese janë paraqitur (1) si gjendje kumulative dhe (2) si kredi të reja të dhëna gjatë muajit. Në kuadër të kredive kumulative është përfshirë vlera e kredive aktive, respektivisht kërkesave të korporatave tjera depozituese ndaj sektorëve përkatës, korporatave publike jofinanciare, korporatave private jofinanciare dhe ekonomive familjare, të ndara sipas afateve. Në këtë kontekst, nuk është përfshirë aktiviteti ndër bankar kreditor. Kreditë e reja përfshijnë kreditë e dhëna vetëm brenda një periudhe referuese dhe si të tilla janë të dhëna jo kumulative (p.sh. kreditë për muajin shkurt 2010 paraqesin vetëm kreditë e dhëna gjatë atij muaji, duke mos përfshirë kreditë e dhëna gjatë periudhave paraprake, siç është rasti tek kreditë kumulative). Përveç ndarjes në sektorët dhe nën sektorët institucional, kreditë janë ndarë edhe sipas qëllimit. Kjo ndarje është bazuar në klasifikimin NACE lidhur me sektorët ekonomik.⁴

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 10. Normat e interesit të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin

⁴ Për më shumë rreth klasifikimit NACE shih http://epp.eurostat.ec.europa.eu/cache/ITY_OFFPUB/KS-RA-07-015/EN/KS-RA-07-015-EN.PDF

financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Normat e interesit llogariten dhe publikohen duke përdorur normën efektive vjetore. Sektorët janë ndarë korporatat jofinanciare (publike dhe private) dhe në ekonomitë familjare, konsistente me standardet ndërkombëtare. Që nga janari 2008 ka një ndryshim metodik ku në kuadër të normave të interesit në kredi përfshihen edhe shpenzimet administrative që aplikohen nga banka komerciale për kreditë e dhëna e që paguhet nga kredimarrësit. Po ashtu, që nga janari 2008, statistikat lidhur me mbitërheqjet paraqiten si kumulative dhe si të tilla nuk përfshihen me rastin përlllogaritjes së normës së mesatares së ponderuar aritmetike. Me rastin e llogaritjes dhe publikimit të normës efektive të kamatës për të gjitha korporatat tjera depozituese, përdoret mesatarja e ponderuar aritmetike dhe kriteret si devijimi standard, minimumi i observimeve, etj. Formula e llogaritjes së normës efektive është me sa vijon:

$$AAR = \left(1 + \frac{AG}{n}\right)^n - 1$$

ku AAR është norma e kontraktuar e vjetorizuar, AG paraqet normën nominale të kontraktuar në mes të palëve, dhe n është numri i periudhave të kapitalizimit brenda vitit. Atëherë, $n = 1$ nëse interesi paguhet një herë në vit (12/12), $n = 2$ kur interesi paguhet çdo gjashtë muaj (12/6), $n = 4$ kur interesi paguhet çdo tre muaj (12/3), dhe $n = 12$ kur interesi paguhet çdo muaj (12/1).

Këto të dhëna janë jo kumulative që përfshijnë kontratat e reja gjatë muajit përkatës. Për më shumë rreth llogaritjes së normës së interesit konsultoni [Metodikën mbi statistikën monetare dhe financiare](#).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 11. Bilanci i suksesit të korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera depozituese janë bankat komerciale. Bilanci i suksesit i korporatave tjera depozituese paraqet gjendjen e agreguar të të hyrave dhe shpenzimeve bankare. Struktura e të hyrave ndahet sipas kriterit të mjeteve që sjellin interes (të hyrat nga interesi) dhe të hyrave të tjera. I njëjti kriter aplikohet edhe tek klasifikimi i shpenzimeve. Të dhënat në bilancin e suksesit të dhënat janë jo kumulative, respektivisht, prezantohen si kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 12. Sistemi i pagesave

Përshkrimi: Të dhënat lidhur me pagesat ndërbankare përfshinë statistika lidhur me vlerën e mbitërheqjeve në bankomate, pikave të shitjes (POS), shfrytëzimit të e-bankingut, etj. Këto statistika janë informata kumulative brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009). Për dallim nga statistikat që paraqesin vlerën e transaksioneve, statistikat mbi numrin e bankomatëve, pikave shitëse elektronike (Point of Sale), llogarive bankare si dhe numri i llogarive e-banking janë të dhëna kumulative.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 13. Transferet ndërkombëtare

Përshkrimi: Në kuadër të transfereve ndërkombëtare janë paraqitur transferet hyrëse dhe dalëse, sipas nën sektorëve. Të dhënat janë paraqitur në sistemin kumulativ brenda vitit kalendarik (p.sh. të dhënat për janar 2009 përfshijnë të dhënat vetëm për janar 2009, ndërsa të dhënat për qershor 2009 përfshijnë të dhënat që nga janari 2009 deri në qershor 2009). Në kuadër të transfereve të BQK-së dhe korporatave tjera depozituese (bankave komerciale) përveç transfereve të klientëve, janë përfshirë edhe transferet në emër të institucioneve, BQK-së dhe bankave komerciale.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 14. Kreditë e ndërmjetësve të tjerë financiar

Përshkrimi: Ndërmjetësit tjerë financiar përfshijnë të gjitha korporatat financiare përveç korporatave depozituese, kompanive të sigurimit, fondeve pensionale, dhe ndihmësve financiar. Në rastin e Kosovës, ndërmjetësit tjerë financiar përbëhen nga institucionet mikrofinanciare. Vlera dhe numri i kredive janë të dhëna kumulative. Ndërmjetësit tjerë financiar përfshijnë institucionet mikrofinanciare të cilat së bashku me korporatat tjera depozituese (bankat komerciale) janë institucionet e vetme në kuadër të sistemit financiar të Kosovës të licencuara për dhënien e kredive. Shuma e kredive është paraqitur në bazë bruto.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 15. Rrjeti dhe stafi i korporatave tjera depozituese

Përshkrimi: Korporatat tjera depozituese përbëhen nga korporatat dhe kuazi korporatat financiare rezidente (përveç bankës qendrore) që janë të angazhuara në ndërmjetësimin financiar dhe që obligimet e tyre janë pjesë e parasë së gjerë. Në Kosovë, korporatat tjera

depozituese janë bankat komerciale. Të dhënat mbi rrjetin e korporatave tjera depozituese (bankave komerciale) janë paraqitur në nivel të rajoneve të Kosovës. Në kuadër të njësieve bankare përfshihen zyrat kryesore, degët, nëndegët, dhe të gjitha njësitë tjera bankare. Të dhënat mbi rrjetin bankar dhe mbi stafin e bankave komerciale janë të dhëna kumulative.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 16. Aktiviteti i kompanive të sigurimeve

Përshkrimi: Kompanitë e sigurimeve janë korporata financiare që janë të angazhuara në aktivitetet e sigurimit të automjeteve, sigurimit të dëmeve, sigurimit jetësor, etj. Në kuadër të aktivitetit të kompanive të sigurimit janë paraqitur të hyrat në emër të sigurimeve vendore të automjeteve (sigurimet ndaj palës së tretë), sigurimet kufitare dhe sigurimet tjera (sigurimi i pronave, sigurimet nga zjarri, dhe sigurimet nga fatkeqësitë tjera). Konsistent me këtë ndarje janë paraqitur edhe numri i policave të shitura si dhe shpenzimet e kompanive të sigurimit.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 17. Buxheti i Kosovës

Përshkrimi: Tabela mbi buxhetin e Kosovës prezanton të hyrat dhe shpenzimet faktike buxhetore. Të hyrat janë ndarë në të hyra kufitare dhe vendore të cilat më pastaj janë detajuar sipas llojit të tatimit (TVSH, tatim i paragykuar, etj). Me qëllim të konsistencës me raportin nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, të dhënat mbi donatorët nuk janë paraqitur në kuadër të të hyrave të qeverisë. Shpenzimet buxhetore janë paraqitur bazuar në qëllimin e shpenzimit të detajuar sipas bartësve (niveleve qeveritare).

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Tabela 18. Produkti i brendshëm bruto

Përshkrimi: Të dhënat mbi Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) janë të dhëna nominale. Në kuadër të të dhënave mbi konsumin e qeverisë përfshihen edhe pagat e stafit ndërkombëtar që punon në Kosovë. Kategoria IJPSHESH ka të bëjë me organizatat jo me qëllim fitimi që i shërbejnë ekonomive familjare që në Buletin Mujor Statistikor është prezantuar si OJSHEF. Në kuadër të eksportit neto përfshihen eksporti dhe importi i mallrave (duke përfshirë shpenzimet e transportit dhe të sigurimit: c.i.f) si dhe eksporti dhe importi i shërbimeve. Statistikat e PBB-së janë paraqitur sipas qasjes së shpenzimeve dhe sipas sektorëve ekonomik.

Periodiciteti: Vjetor

Burimi i të dhënave: Enti i Statistikës së Kosovës

Tabela 19. Çmimet

Përshkrimi: Statistikat mbi çmimet përpilohen sipas klasifikimit të konsumit individual sipas qëllimit (COICOP) duke përdorur peshat specifike në nivel të çdo kategorie dhe nën kategorie.⁵ Statistikat mbi çmimet mblidhen nga qendrat rajonale siç janë Ferizaj, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Prishtina. Statistikat mbi çmimet janë paraqitur bazuar në ndryshimin vjetor të çmimeve dhe sipas sistemit të mesatares vjetore. Përderisa ndryshimi vjetor është bazuar në formulën e rritjes vjetore, mesatarja vjetore përdoret duke marrë për bazë mesataren e 12 muajve të fundit dhe pjesëtuar me mesataren e 12 muajve të parafundit (p.sh. çmimet për dhjetor 2009 janë llogaritur duke marrë për bazë mesataren e indekseve për periudhën janar 2009 - dhjetor 2009 dhe duke pjesëtuar me mesataren janar 2008 - dhjetor 2008). Formula për llogaritjen e ndryshimit vjetor si dhe të mesatares vjetore të çmimeve është me sa vijon:

$$\text{Ndryshimi vjetor} = \left[\left(\frac{CPI^{Y,m}}{CPI^{Y-1,m}} \right) - 1 \right] * 100$$

ku $CPI^{Y,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit aktual, ndërsa $CPI^{Y-1,m}$ paraqet indeksin e çmimeve për muajin aktual të vitit paraprak.

$$\text{Mesatarja vjetore} = \frac{\sum_{i=1}^m CPI^{Y,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-1,12}}{\sum_{i=1}^m CPI^{Y-1,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-2,12}}$$

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Enti i Statistikës së Kosovës

Tabela 20. Bilanci i pagesave

Përshkrimi: Statistikat e bilancit të pagesave janë të dhëna jo kumulative. Statistikat e bilancit të pagesave përpilohen dhe publikohen sipas standardeve ndërkombëtare, duke paraqitur për kredinë dhe debinë në nivel të çdo komponenti. Kategoria e mallrave përfshinë edhe shpenzimet e sigurimit dhe transportit. Në kuadër të transfereve rrjedhëse, është përfshirë edhe buxheti i UNMIK-ut i cili si institucion, për qëllime statistikore trajtohet si jo rezident, ndërsa stafi i tij, trajtohet bazuar në kriterin e rezidencës (periudha një vjeçare). Ky trajtim vlen edhe për EULEX-in. Po ashtu edhe KFOR-i është pjesë e bilancit të pagesave të Kosovës. Për më shumë rreth trajtimit të UNMIK-ut, EULEX-it, KFOR-it, etj, shih Metodikën mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave të Kosovës.

⁵ Për më shumë rreth klasifikimit COICOP shih <http://unstats.un.org/unsd/cr/registry/regcst.asp?Cl=5>

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 21. Dërgesat e emigrantëve

Përshkrimi: Statistikat mbi dërgesat e emigrantëve (remitancat) janë paraqitur sipas kanaleve të dërgimit dhe shteteve. Ndarja e dërgesave të emigrantëve sipas kanaleve është bërë duke u bazuar në kanalet institucionale (bankat komerciale dhe agjencitë për transferimin e mjeteve) dhe kanalet joinstitucionale. Këto statistika janë jo kumulative.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 22. Investimet e huaja direkte

Përshkrimi: Statistikat mbi investimet e huaja direkte janë paraqitur sipas sektorëve dhe shteteve. Ndarja e investimeve të huaja sipas kategorive ekonomike është bazuar në fushën e investuar dhe përfshin investimet nga procesi i privatizimit dhe investimet e reja. Këto statistika janë jo kumulative.

Periodiciteti: Tremujor

Burimi i të dhënave: BQK

Tabela 23. Bilanci tregtar

Përshkrimi: Statistikat mbi bilancin tregtar janë paraqitur sipas shteteve dhe komponentëve kryesore. Shtetet janë grupuar në shtetet e Bashkësisë Evropiane, CEFTA-s, vendeve të tjera evropiane dhe jo evropiane. Eksportet janë paraqitur sipas shtetit destinues, ndërsa importi i të mallrave është bërë sipas shtetit të origjinës. Në kuadër të bilancit tregtar është paraqitur edhe tabela mbi importin e mallrave e ndërthurur me komponentë kryesor (prezantimi matricor) që tregon kategorinë e mallrave të importuar sipas shtetit përkatës.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: Enti i Statistikës së Kosovës dhe llogaritjet e BQK-së

Tabela 24. Kursi devizor

Përshkrimi: Kursi devizor përpilohet bazuar në mesataren mujore të valutave kundrejt valutës euro. Valutat e paraqitura janë valuta të shteteve që paraqesin partnerët kryesor tregtar të Kosovës dhe vendeve të rajonit. Për qëllime informative, është paraqitur edhe dollari amerikan i krahasuar me valutën euro. Norma Reale Efektive të Këmbimit (NREK) llogaritet duke përdorur Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) dhe Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Para se të llogaritet NREK, që më parë

duhet të llogarisim Normën Nominale Efektive e Këmbimit (NNEK). Formula lidhur me llogaritjen e NNEK-ut është me sa vijon:

$$NNEK_t = 100 \sum_{i=1}^n \frac{E_{it}}{E_{i0}} w_i$$

ku i paraqet valutat individuale të vendeve, E_{it} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendeve në baza mujore (t) e definuar si numri i njësive të valutës së vendit (i) për një njësi të valutës vendore, E_{i0} paraqet normën nominale të këmbimit të valutës euro në raport me valutat e vendit përkatës në periudhën bazë, dhe w_i është pesha për valutën e vendit (i).

Më pastaj llogarisim NREK-un bazuar në formulën me sa vijon:

$$NREK_t = \sum_{i=1}^n \frac{w_i P_{dt}}{P_{ft}} NNEK_t$$

ku P_{ft} paraqet indeksin për çmimet e huaja në baza mujore (t) për secilin vend veç e veç duke krahasuar me periudhën bazë, përderisa P_{dt} paraqet IÇK-në e Kosovës në baza mujore (t) krahasuar me periudhën bazë.

Periodiciteti: Mujor

Burimi i të dhënave: BQK



RRUGA E GARIBALDIT, NR.33, PRISHTINË, KOSOVË
TEL: +381 38 222 055; FAX: +381 38 243 763
WEB: [HTTP://WWW.BQK-KOS.ORG](http://www.bqk-kos.org)